



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

## **Kërkesë për Shprehje Interesi**

Shteti: Kosova

ID e projektit: P171098

Emërtimi i Kredisë nga Banka Botërore: Projekti për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës

### **Ekspert i komunikimit**

#### **Konteksti**

Republika e Kosovës ka marrë një kredi nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 47.0 milionë euro për financimin e Projektit për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës (PRSASK). Objektivi i projektit është të përmirësojë barazinë dhe përshtatshmërinë e rritjes të sigurisë sociale të Kosovës. Përmirësimi i barazisë do të përfshijë zgjedhjen e përfituesve të SAS bazuar në statusin e varfërisë (në vend të kategorive), ofrimin e përfitimeve më të përshtatshme, duke përfshirë një rritje të përfitimit për kokë banori të marrë nga familjet më të mëdha dhe sigurimin që përfituesit e aftë për punë të përfitojnë nga masat e aktivizimit. Përmirësimi i përshtatshmërisë i referohet rritjes së kapacitetit të rritjes të sigurisë sociale të Kosovës për t'iu përgjigjur ndryshimeve në nivelet e varfërisë në Kosovë si dhe ndaj goditjeve, përfshirë ato që janë të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, për të minimizuar ndikimet negative në nivelin e varfërisë së familjeve. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) është agjencia zbatuese e projektit RSASK në kuadër të të cilit do të krijohen Njësitë e Koordinimit të Projekteve (NjKP). NjKP do të ketë një Koordinator Projekti, Specialist Prokurimi, Specialist të Menaxhimit Financiar dhe staf tjetër teknik si Ekspert Social, Ekspert i Komunikimit dhe Menaxher i Detyrave IT.

NjKP do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përditshëm të Projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve të projektit. NjKP do të jetë përgjegjëse për të gjitha aspektet e fiduciare, të tilla si prokurimi, menaxhimi financiar, monitorimi dhe vlerësimi, dhe masat mbrojtëse në kuadër të Projektit.

Komponentët e projektit janë: Komponenti 1 – Forcimi i sistemeve të ofrimit të mbrojtjes sociale; Komponenti 2 – Përmirësimi i performancës së Skemës së Ndhmës Sociale; dhe Komponenti 3 – Zbatimi dhe menaxhimi i projektit.

#### **Përgjegjësitë e Ekspertit të Komunikimit**

Eksperti i Komunikimit do të mbështesë NjKP-në dhe do të ndihmojë MFPT-në në ndarjen e informacionit, rritjen e ndërgjegjësisimit për proceset përkatëse dhe promovimin e shërbimeve përkatëse për publikun e

gjerë dhe grupet e interesit. Eksperti i Komunikimit do të jetë i ngarkuar me këto detyra: të planifikojë dhe drejtojë zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të komunikimit dhe planeve të shpërndarjes në mënyrë që të ruajë perceptimet e favorshme të publikut dhe të palëve të interesuara, të krijojë dhe të mbajë marrëdhënie bashkëpunuese me përfaqësuesit e qeverisë, Qendrat për Punë Sociale, departamentet përkatëse komunale dhe grupet e interesit publik dhe palët e prekura nga Projekti; dhe të mbështesë NjKP-në për të planifikuar angazhimin e qytetarëve duke ofruar informacione dhe konsultime, si dhe duke përfshirë reagimet e marra në projekt.

*Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Ekspertit të Komunikimit janë të shënuara në TeR-në e bashkangjitur.*

### **Kualifikimet e nevojshme**

- Diplomë universitare në komunikim në media, shkenca sociale, sociologji, marrëdhënie me publikun ose fusha të ngjashme (diploma master konsiderohet si avantazh);
- Minimumi 3 vjet përvojë profesionale në lidhje me komunikimin dhe 1 vit përvojë specifike/përkatëse në shpërndarjen e informacionit dhe shërbimeve që lidhen me zbatimin e projekteve të financuara nga BB ose donatorë të tjerë ndërkombëtarë;
- Njohja me planifikimin e hartimit dhe ofrimit të fushatave informative;
- Njohuri e mirë e ambientit mediatik dhe të komunikimit në vend;
- Aftësi të mira për të shkruar lajme;
- Aftësi të mira komunikimi, duke përfshirë aftësitë për rrjete sociale dhe multimedia, si dhe aftësi të forta ndërpersonale dhe për të krijuar rrjetë të kontakteve;
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze e domosdoshme, gjuha serbo-kroate është përparësi;
- Njohuri mbi funksionimin e kompjuterit;
- Të ketë një rekord të pastër në policinë e shtetit, të mos ketë asnjë kufizim në të drejtat civile dhe të mos ketë qenë përfshirë më parë në mashtrim financiar.

### **Periudha e Performancës**

Eksperti i Komunikimit do të punojë me kohë të plotë dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të fillojë në qershor 2023 deri në dhjetor 2026. Kohëzgjatja e kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme të rënë dakord gjatë një vlerësimi zyrtar të planifikuar në fund të çdo viti, me 6 muajt e parë të provës. Kompensimi do të bëhet në bazë të tarifës mujore të rënë dakord në kontratë. Konsulenti pritet të fillojë me ofrimin e shërbimeve me nënshkrimin e kontratës.

### **Procesi i përzgjedhjes:**

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të zgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve të Investimeve (FPI), korrik 2016, bazuar në thirrjen e hapur.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- Kualifikimi i përgjithshëm - 30 pikë
- Përvoja specifike në lidhje me detyrën – 70 pikë

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës: 08:00 - 16:00 (nga e hëna në të premte)

Shprehja e interesit duke përfshirë një CV dhe një Letër Motivimi mund të dorëzohet në adresën e treguar më poshtë deri më **31 maj 2023 në orën 16:00**.

***Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve***

*Personi kontaktues: Henrieta Vula – Zyra e Prokurimit në MFPT*

*Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, Kati 13, Sheshi “Nënë Tereza”-10000, Prishtinë,*

*Numri i telefonit: +383 38 200 34 142*

*E-mail: [Henrieta.Vula@rks-gov.net](mailto:Henrieta.Vula@rks-gov.net)*

# TERMAT E REFERENCËS

## PROJEKTI I REFORMËS SË SISTEMIT TË NDIHMËS SOCIALE TË KOSOVËS

### Eksperti i komunikimit

#### Konteksti

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në Republikën e Kosovës ka pranuar një kredi nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 47 milionë euro për financimin e Projektit për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës. Objektivi i projektit është të përmirësojë barazinë dhe përshtatshmërinë e rrjetit të sigurisë sociale të Kosovës. Përmirësimi i barazisë do të përfshijë zgjedhjen e përfituesve të SAS bazuar në statusin e varfërisë (në vend të kategorive), ofrimin e përfitimeve më të përshtatshme, duke përfshirë një rritje të përfitimit për kokë banori të marrë nga familjet më të mëdha dhe sigurimin që përfituesit e aftë për punë të përfitojnë nga masat e aktivizimit. Përmirësimi i përshtatshmërisë i referohet rritjes së kapacitetit të rrjetit të sigurisë sociale të Kosovës për t'iu përgjigjur ndryshimeve në nivelet e varfërisë në Kosovë si dhe ndaj goditjeve, përfshirë ato që janë të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, për të minimizuar ndikimet negative në nivelin e varfërisë së familjeve. Këto objektiva do të arrihen duke mbështetur qeverinë për (a) reformimin e dizajnit të SAS, (b) të bëjë investime në sistemet e ofrimit të SAS dhe (c) të rrisë vlerën e përfitimit të SAS për të zbutur efektet ekonomike të pandemisë COVID-19. Së bashku, këto investime parashikohet të çojnë në një rrjet sigurie sociale që është më e qasshme për familjet më të varfra, ofron përfitime më domethënëse dhe mund të kontraktohet ose zgjerohet në përgjigje të ndryshimeve në nivelet e varfërisë ose goditjeve.

#### OBJEKTIVI I DETYRËS

Objektivi kryesor i kësaj detyre është të ndihmojë MFPT-në dhe Njësinë e Koordinimit të Projektit (NJKP) të Projektit për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës në shkëmbimin e informacionit, rritjen e ndërgjegjësimit për proceset përkatëse dhe promovimin e shërbimeve të ndryshme për publikun e gjerë dhe grupet e interesit, duke përfshirë njerëz të varfër dhe të pambrojtur.

#### FUSHA E PUNËS

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Funkcionet kryesore të Ekspertit të Komunikimit do të përfshijnë sa vijon:

- Studimi i objektivave, politikave dhe nevojave të Projektit me synimin e zhvillimit të strategjive të marrëdhënieve me publikun që do të promovojnë misionin, projektet dhe shërbimet;
- Planifikimi dhe drejtimi i zhvillimit dhe zbatimit të strategjive të komunikimit dhe planeve të shpërndarjes në mënyrë që të ruhen perceptimet e favorshme të publikut dhe të palëve të

interesuara për arritjet dhe agjendën e organizatës në mesin e publikut të gjerë dhe të komuniteteve të varfëra dhe të cenueshme, të cilët mund të mos jenë në gjendje të kenë qasje në mediat kryesore;

- Mbështetja e MFPT-së/Departamentit të Skemave Sociale (DSS) për të siguruar që reforma e ardhshme e SAS t'i komunikohet mirë publikut të gjerë për të siguruar mbështetje me bazë të gjerë, dhe gjithashtu t'u komunikohet grupeve të veçanta, siç janë përfituesit ekzistues të SAS.
- Krijimi dhe të mbajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me përfaqësuesit e qeverisë, Qendrës për Punë Sociale, departamenteve përkatëse komunale dhe grupeve të interesit publik dhe palëve të prekura nga Projekti;
- Mbështetja e NjKP-së për të planifikuar angazhimin e qytetarëve duke ofruar informacione dhe konsultime, si dhe duke inkorporuar komentet e marra në projekt, në koordinim me ekspertin social;
- Në koordinim me Ekspertin Social, planifikimi dhe mbështetja e kërkesës së rregullt të komenteve, në formate të tilla si punëtori dhe grupe pune për QPS-të, Zyrat e Punësimit dhe partnerët si komunat, donatorët, OJQ-të dhe grupet e fokusit; për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që përfaqësojnë grupet e prekura; dhe për përfituesit;
- Koordinimi me ndërhyrje të tjera të mbështetura nga donatorët në lidhje me aktivitetet përkatëse të komunikimit;
- Përgatitja ose redaktimi i publikimeve organizative për audiencat e brendshme dhe të jashtme, dokumentet e informacionit të projektit, materialet informuese, përmbajtjet e internetit dhe materiale të tjera informative publike;
- Organizimi i paraqitjes publike, broshurave, sesioneve informuese ose ekspozitave për përfituesit e Projektit për të rritur ndërgjegjësimin për shërbimin dhe për të promovuar vullnetin e mirë;
- Hartimi i Termave të Referencës, mbikëqyrja e konsulentëve dhe rishikimi i rezultateve, sipas nevojës, për detyrat që lidhen me komunikimin;
- Udhëheqja e prodhimit të materialeve informative dhe promovuese në lidhje me qëllimet dhe aktivitetet e Projektit;
- Përgatitja ose redaktimi i fjalimeve dhe prezantimeve për NjKP-në dhe për stafin përkatës të Ministrisë për të çuar përpara objektivat e marrëdhënieve me publikun;
- Trajnimi i përfaqësuesit përkatës të Ministrisë dhe stafit të NjKP-së në komunikim efektiv me publikun dhe palët e interesuara.
- Blerja e hapësirës dhe kohës së reklamimit, sipas nevojës, për të promovuar aktivitetet e projektit dhe shërbimet e qeverisë në lidhje me punën e projektit për publikun, palët e prekura nga Projekti dhe palët e interesuara;
- Mirëmbajtja dhe modifikimi i faqes së internetit (futja e informacionit) dhe publikime të ndryshme; dhe,
- Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve të angazhimit qytetar për të përcaktuar parametrat për kërkimin e komunikimit, vlerësimin e reputacionit, testimin e shërbimeve të komunikimit, etj., në koordinim me ekspertin social.

## KUALIFIKIMET

Eksperti i komunikimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Diplomë universitare në komunikim në media, shkenca sociale, sociologji, marrëdhënie me publikun ose fusha të ngjashme (diploma master konsiderohet si avantazh);
- Minimumi 3 vjet përvojë profesionale në lidhje me komunikimin dhe 1 vit përvojë specifike/përkatëse në shpërndarjen e informacionit dhe shërbimeve që lidhen me zbatimin e projekteve të financuara nga BB ose donatorë të tjerë ndërkombëtarë;
- Njohja me planifikimin e hartimit dhe ofrimit të fushatave informative;
- Njohuri të mira të mjedisit mediatik dhe komunikativ të vendit;
- Aftësi të mira për të shkruar lajme;
- Aftësi të mira komunikimi, duke përfshirë aftësitë e rrjeteve sociale dhe multimedia, si dhe aftësi të forta ndërpersonale dhe të rrjetëzimit;
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze e domosdoshme, gjuha serbo-kroate është përparësi;
- Njohuri mbi funksionimin e kompjuterit; dhe,
- Të ketë një rekord të pastër në policinë e shtetit, të mos ketë asnjë kufizim në të drejtat civile dhe të mos ketë qenë përfshirë më parë në mashtrim financiar.

## KOHËZGJATJA DHE ORARI I PAGESËS

Puna e konsulentit do të zhvillohet ndërmjet korrikut 2023 dhe qershorit 2024 me mundësi zgjatjeje. Konsulenti do të punojë me kohë të plotë bazuar në një vlerësim të mirë të performancës vjetore dhe gjashtë muajt e parë si punë provuese.

Konsulenti do të paguhet në baza mujore sipas një tarife të rënë dakord përpara nënshkrimit të kontratës. Të gjitha termat dhe kushtet do të përshkruhen në kontratën e konsulentit. Kontrata do të bazohet në modelin Standard të Bankës për Detyrat e Vogla të Bazuara në Kohë. Konsulenti do të mbajë shënime të sakta për kohën e tij/saj të kaluar në Projekt dhe shpenzimet e tij/saj (siç autorizohet në kontratë). Përpara çdo pagese, Koordinatorin e Projektit dhe drejtuesin e subjektit zbatues (Departamenti i Skemave Sociale (DSS) – Drejtori) duhet të miratojnë cilësinë e punës së kryer nga konsulenti.

Konsulenti do të komunikojë rregullisht me Koordinatorin e Projektit, Drejtorin e Departamentit të Skemave Sociale (DSS) dhe stafin përkatës dhe palët e interesuara.

Klienti do të sigurojë hapësirën e zyrës dhe pajisjet e nevojshme për të kryer detyrat e caktuara sipas kësaj konsulence.

## RAPORTIMI I MARRËDHËNIEVE DHE DETYRIMEVE

1. Eksperti i Komunikimit për Projektin e Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës do t'i raportojë Koordinatorit të Projektit dhe Drejtorit të Departamentit të Skemave Sociale (DSS).

2. Ai/ajo do të dorëzojë:

- a) Planin 10-mujor të Komunikimit të Projektit, me tregues të matshëm;
- b) Një Analizë dhe Hartë të Palëve të Interesit;
- c) Një plan konsultimi me palët e interesuara;
- d) Raportet mujore dhe gjashtëmujore të progresit;
- e) Termat e referencës për firmën për të mbështetur zbatimin e Planit të Komunikimit të projektit;
- f) Postimi mbi aktivitetet e projektit në faqet përkatëse të internetit dhe rrjetet sociale përkatëse sipas nevojës;
- g) Drejtimi dhe koordinimi i prodhimit të materialit informues në gjuhët lokale ose ngjarjet siç është rënë dakord me Koordinatorin e Projektit;
- h) Mbështetja e zhvillimit të planit dhe aktiviteteve të angazhimit qytetar; dhe
- i) Raporte të tjera sipas kërkesave në Manualin Operativ të Projektit dhe Dokumentin e Vlerësimit të Projektit.

3. Raportet e brendshme dhe komunikimi me shkrim në lidhje me zbatimin e projektit do të jenë në gjuhën angleze.

4. Fletët e kohës: Konsulenti, rregullisht dhe në kohë, do të përgatisë një fletë kohore për punën e bërë.